

# AKT THEMELUES

## I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "2 Z KONSTRUKSION" SH.P.K.

Qene Zani Zoga, i biri i Skenderit, Datelindja 1965, banues ne Fier, Lagjia "15 Tetori", mbeshtetur ne nenin 251, shkronja "G" te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te vepritarise private dhe privatizimit", krijoi shoqerine tregetare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "2 Z KONSTRUKSION" dhe hartoi kete akt themelues si vijon:

### F O R M I M I

#### NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur "2 Z KONSTRUKSION" sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakut themelues.

### VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

#### NENI 2

Vend-qendrimi i shoqerise tregetare private "2 Z KONSTRUKSION" sh.p.k. do te jete ne Fier, Lagjia "15 Tetori".

Shoqeria do te hape edhe vend-qendrimet te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

1. Zbatim punime ndertimi ne kategorite:
  - Punime dheu, sistemime, tarracime etj.
  - Ndertime civile dhe ekonomike.
  - Ndertim rruge kategoria e IV dhe V.
  - Ndertim uje-sjelllesa dhe kanalizime.
  - Ndertim sillosa, kulla uji prej betonarmeje dhe metalike.
  - Rikonstruksione godina civile dhe ekonomike, veshje fasade.
- 2- Tregetimit me shumice e pakice dhe import-eksport te:
  - mallra industriale, ushqimore, elektro-shtepiake, konfeksione.
  - mallra bujqesore e blegtorale, bime medicinale e mjekesore.
- 3- Prodhim dhe tregetim materiale ndertimi me shumice e pakice dhe import-eksport.
4. Transport mallra brenda e jashte vendit.



NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj, shoqeria do te hape njesi, prodhimi, perpunimi, tregetimi, sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregetare private "2 Z KONSTRUKSION" sh.p.k. do te jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga kuota e ortakut te vetem, themelues te shoqerise.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut.

Kuota e ortakut ne kapital eshte e gjitha e emeruar dhe e pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nen-shkrueshem.

NENI 7

Ortaku duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortakut i vetem themelues i shoqerise, z. **Zani Zoga**.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem themelues te shoqerise.

NENI 10

Ortaku i vetem emeron edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtoje persona te tjere si ortak.

Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.



NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen ne Gjykaten e Rrethit Fier, sipas statutit te shoqerise, kontrates se lidhur me palet dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregtare".

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente.

NENI 15

Akti i themelimit u perpilua ne disa kopje per tiu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private "2 Z KONSTRUKSION" sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet regullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

" 2 Z KONSTRUKSION " sh.p.k.

Zani Zoga